



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI  
KOMISIONERI

Nr. 214/3 prot.

Tiranë, më 05.06.2026

**V E N D I M**

**Nr. 155, datë 05. 06. 2026**

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar<sup>1</sup>, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 29, datë 26.01.2026, e paraqitur nga znj. M.Ç kundër Ministrisë së Arsimit, Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë dhe Bashkisë Korçë, në të cilën pretendon diskriminimin e vajzës së saj të mitur V.Ç, për shkak të “aftësisë së kufizuar” dhe “gjendjes ekonomike”.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi<sup>2</sup>,

**K O N S T A T O I:**

**I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues**

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, pala ankuese parashtron: “*Quhem M.Ç. Jam banore e Bashkisë Korçë. Jam nëna e tre fëmijëve të cilët frekuentojnë shkollën 9-vjeçare “Asdreni” përkatësisht në klasën e parë, të pestë dhe të nëntë. Jam person me aftësi të kufizuara, pasi trajtohem me paaftësi nga bashkia në shumën 8958 lekë. Po ju drejtohem ju si institucion për shkak të problematikës që kam në lidhje me mospërfitimin e bursës për njërën nga vajzat e mia. Më poshtë po ju shpjegoj situatën:*

*Në muajin tetor 2025, lajmërohem nga mësueset e fëmijëve për të përgatitur dokumentacionin lidhur me përfitimin e bursës të VKM 666, datë 10.10.2019, për të tre vajzat e mia, pasi siç u shpreha më lart jam person me aftësi të kufizuara dhe bashkëshorti im trajtohet me ndihmë ekonomike. Pasi përgatita dokumentacionin përkatës (si përfituese në pikat 2.1 dhe 2.3/d) i dorëzoj*

<sup>1</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën LMD.

<sup>2</sup> Në vijim do t’i referohemi me shkurtesën Komisioneri.

pranë shkollës për të tre vajzat e mia, ku nga këta të fundit pajisem dhe me procesverbalin ku shënohet që dokumentacioni i dorëzuar është i rregullt.

Në muajin dhjetor, mësueset përkatëse më lajmërojnë që 2 vajzat e mia janë përfituese, kurse e treta jo. Kërkoj shpjegim se cila është arsyeja e mospërfitimit të bursës për vajzën dhe nga ana e mësueses kujdestare më thuhet që nuk është në dorën time por e ka bashkia.

Paraqitem pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdheve, ku kontaktoj një prej punonjësve të saj, e cila më shpjegon lidhur me situatën në të cilën thekson se dokumentacioni është i rregullt, por edhe pse është brenda afatit kohor, ky fëmijë nuk është përzgjedhur pasi janë marrë në konsideratë të gjitha dokumentet e dorëzuara deri në datën 17 tetor 2025 (ku në to futen dhe emrat e dy vajzave të mia, pasi në procesverbal ato mbajnë data të ndryshme para 17 tetorit, kurse e treta është në datën 20 tetor, edhe pse unë i kam dorëzuar të gjitha në një ditë. Nuk e di se çfarë ka ndodhur me datat në procesverbale) ngaqë numri i kërkesës ka qenë shumë më i lartë nga numri i bursave të ofruara nga Ministria e Arsimit dhe bashkia ka mbuluar një pjesë të tyre, por në pamundësi për të gjithë ka kërkuar përsëri nga Ministria e Arsimit rritjen e numrit të kuotave, kjo nëpërmjet një shkrese dërguar nga ky institucion. Problemi qëndron dhe në diçka tjetër nga fjala që mësuesit më thonë: të janë trajtuar dy dhe e treta jo, ndërkohë që i gjithë dokumentacioni është dorëzuar në të njëjtën kohë, pse duhet të ndodhë ky diskriminim për njërin nga vajzat?”.

Ankuesja kërkon nga Komisioneri, hetimin e rastit, konstatimin e diskriminimit për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes ekonomike dhe përfitimin e bursës për vajzën e saj V.Ç.

## II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Komisioneri mori në shqyrtim ankesën bazuar në kompetencën e parashikuar nga neni 32, pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, që i jep të drejtën për të shqyrtuar ankesat nga personat ose grupet e personave që pretendojnë se janë diskriminuar, sipas parashikimeve të këtij ligji.

LMD, rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit, bazuar në një listë të hapur shkaqesh. Në nenin 1, të LMD përcaktohet: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.”

Sipas nenit 7, të LMD, mbrojtja nga diskriminimi, garantohet ndaj çdo veprimi apo mosveprim të autoriteteve publike ose personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash.

Bazuar në nenin 5, pika 1, të LMD, ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ose procedure, si dhe çdo forme tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të neneve 32 dhe 33, të LMD, Komisioneri ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

1. Me shkresën nr.214/1 prot, datë 02.02.2026, Komisioneri kërkoi informacion nga Ministria e Arsimit, Bashkia Korçë dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Kopshteve dhe Çerdheve, pranë Bashkisë Korçë, në lidhje me ankesën.
2. Me shkresën nr. 107 prot., datë 05.02.2026, ka kthyer përgjigje Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Kopshteve dhe Çerdheve, pranë Bashkisë Korçë, duke parashtruar ndër të tjera se:

*Vlerësimi i kriterëve për përcaktimin e kuotave financiare të ushqimit në mensa dhe konvikte dhe përcaktimi i kriterëve për përfitim të bursave e pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike, bëhet duke u bazuar në :*

*Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”;*

*Vendimit nr.511, datë 27.07.2022 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim të bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*

*Kurse procedura që ndiqet dhe dokumentacioni që kërkohet për përfitim të bursës jemi bazuar në Vendimin e Këshillit të Bashkisë Korçë nr.86, datë 29.08.2025 “Për miratimin e dokumentacionit dhe procedurës për përfitim të bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”.*

Znj. M.Ç ka kërkuar bursë për fëmijën e saj V.Ç nxënëse në shkollën “Asdreni”. Sipas informacionit nga Drejtoria e Shkollës, prindi ka dorëzuar dokumentet për të aplikuar për bursë pranë kësaj drejtorie, nga shkolla janë pranuar dokumentet dhe së bashku me dokumentet e aplikuesve të tjerë janë dorëzuar pranë Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Kopshteve dhe Çerdheve, pranë Bashkisë Korçë. Nga ana jonë dokumentacioni i dorëzuar është pranuar dhe është shqyrtuar së bashku me të gjitha dokumentet e tjera të të gjithë nxënësve që kanë aplikuar për bursë.

Nxënësja nuk ka qenë përfituese e bursës për vitin shkollor 2025-2026 për shkak se numri i bursave të akorduara nga Ministria e Arsimit ka qenë shumë i ulët në krahasim me numrin e aplikuesve. Duke ndjekur me përpikmëri procedurën e miratuar me VKB-në nr.86, datë 29.08.2025, pika 3/h ku thuhet shprehimisht: “Në rast se numri i përfituesve, sipas listës së sipërpërmendur, është më i lartë se numri i bursave të akorduara nga Ministria e Arsimit dhe Sportit, do të përfitojnë bursë ata nxënës që kanë dorëzuar më parë aplikimin pranë shkollës”, numri i kuotave të bursave u plotësua me aplikantët që kishin dorëzuar dokumentacionin e plotë dhe të rregullt deri në datën 17.10.2025.

Duke qenë se ankuesja ka dorëzuar dokumentet për bursë në datën 20.10.2025, bazuar kjo në procesverbalin e aplikimit i cili është firmosur dhe nga prindi, nxënësja nuk ka qenë përfituese e bursës për vitin shkollor 2025-2026. Në lidhje me pretendimin e ankueses se dokumentet i ka dorëzuar të gjitha në të njëjtën datë sqarojmë se zonja ka firmosur procesverbalet e dorëzimit të dokumenteve duke pranuar kështu datën e vendosur në procesverbal.

Fëmija e ankueses, nxënësja V.Ç ka qenë përfituese e bursës për vitin shkollor 2024-2025.

Për vitin shkollor 2025-2026, për shkak se nga Ministria e Arsimit shkresa për planifikimin e numrit të bursave nuk erdhi në muajin shtator, si vitet e tjera, procedura e njoftimit filloi në datën 06.10.2025. Njoftimi i shkollave u bë nëpërmjet e-mailit dhe njëkohësisht u publikua dhe në faqen zyrtare të Bashkisë Korçë. Modelet e procesverbaleve u hartuan nga ana jonë bazuar në dokumentacionin e miratuar me VKB-në nr.86, datë 29.08.2025 dhe ju dërguan të gatshme drejtorive të shkollave dhe u udhëzuan t'i plotësonin në momentin që prindërit dorëzonin dokumentet, si dhe një kopje të firmosur nga të dyja palët t'ia jepnin prindërve. Shkresa për planifikimin e bursave nga Ministria e Arsimit ka ardhur në datën 21.10.2025, protokolluar nga Bashkia Korçë. Në këtë shkresë Ministria kërkonte nga ana jonë numrin e aplikimeve brenda datës 27.12.2025. Me shkresën nr.884 prot., datë 27.10.2025 kemi kthyer përgjigje dhe kemi dërguar numrin e aplikantëve. Duke qenë se afati për dorëzimin e dokumenteve filloi me vonesë ne kemi marrë dokumentacionin deri në datën 31.10.2025, dhe deri në këtë datë kanë qenë 703 aplikime gjithsej.

Nga Ministria e Arsimit për vitin shkollor 2025-2026 numri i bursave të miratuara ka qenë 280 bursa, 70 bursa më pak nga viti i kaluar. Nga fondet e bashkisë janë akorduar 40 bursa, maksimumi që mund të jepej bazuar në buxhetin e bashkisë. Në total për vitin shkollor 2025-2026 kemi pasur 320 bursa.

*Duke parë që numri i aplikantëve, me dokumentacion të rregullt brenda afateve është shumë më i lartë se numri i bursave (542 aplikime të rregullta) nga ana jonë bazuar në vendimin e Këshillit Bashkiak janë përzgjedhur 320 aplikimet e para që janë dorëzuar pranë shkollave duke u mbështetur në datat e procesverbaleve të aplikantëve. Për pjesën tjetër të nxënësve të cilët janë me dokumentacion të rregullt, konkretisht 222 nxënës, i jemi drejtuar me shkresën nr.993 prot., datë 03.12.2025 Ministrisë së Arsimit për mbulimin me kuota për bursa për këta nxënës të cilët nuk përfituan. Nga Ministria e Arsimit na ka ardhur shkresa nr.7802/1, datë 15.12.2025 ku thuhet që ministria e ka bërë shpërndarjen e bursave duke lënë të kuptohet që nuk do të ketë më fonde për bursa.*

*Këto problematika janë shkaktuar nga mungesa e fondeve të transferuara nga ministria përkatëse, pasi nuk arrin të mbulojë kërkesat e të gjithë aplikantëve për bursë.”*

3. Mbështetur në nenin 33/8, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 387 prot, datë 18.02.2026, njoftoi, palët për zhvillimin e seancës dëgjimore me datë 05.03.2026, ora 10.00, për të parashtruar dhe argumentuar në mënyrë të drejtpërdrejtë pretendimet e palëve në proces.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullores së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

Seanca dëgjimore u zhvilluar në datën 05.03.2026. Gjatë seancës dëgjimore të datës 05.03.2026, pala ankuese nuk mori pjesë, ndërsa palët e tjera, konkretisht Ministria e Arsimit dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, morën pjesë. Palët e pranishme, Ministria e Arsimit dhe Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, i qëndruan të njëjtave parashtrime që kishin bërë të njohura gjatë komunikimit shkresor me Komisionerin.

4. Me shkresën 1025/1 prot., datë 12.03.2026<sup>3</sup>, Ministria e Arsimit ka kthyer përgjigje në lidhje me shkresën nr. 214/1 prot., datë 02.02.2025 të Komisionerit si dhe informacionin e kërkuar gjatë seancës dëgjimore, duke sqaruar ndër të tjera se:

*“Në zbatim të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", i ndryshuar, Ministria e Arsimit, me qëllim që çdo nxënës t'i sigurohet e drejta për arsimim në institucionet publike të arsimit parauniversitar, bën shpërndarjen e bursave për njësitë e vetëqeverisjes vendore, pa përfshirë nxënësit që ndjekin arsimin profesional.*

---

<sup>3</sup> Administruar pranë institucionit të Komisionerit me nr. 129/1 prot., datë 17.03.2026.

*Bazuar në vendimin e sipërcituar, Ministria e Arsimit miraton çdo vit kuotat e bursave në përputhje me fondet e parashikuara në buxhetin e shtetit për këtë ministri, duke mbajtur në konsideratë numrin e përgjithshëm të nxënësve nga klasa 1-re deri në klasën e 12-të për çdo njësi të vetëqeverisjes vendore, shpërndarjen e tyre gjeografike, numrin e bursave të miratuara në vitet e kaluara shkollore dhe fondin në dispozicion për mbështetje financiare të bursave për nxënësit që ndjekin arsimin me kohë të plotë në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, si dhe mbi bazën e të dhënave të raportuara nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe institucionet arsimore.*

*Procesi i përcaktimit të kuotave realizohet mbi bazën e kritereve objektive dhe të njëjta për të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore, duke synuar garantimin e një shpërndarjeje të balancuar të fondeve publike në nivel kombëtar dhe respektimin e kufijve buxhetorë të miratuar.*

*Në zbatim të pikës 8, të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e lira të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike", i ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar sipas pikës 6 të këtij vendimi, me vendim të Këshillit Bashkiak, miratojnë dhënien e bursave, sipas kritereve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4 të këtij vendimi.*

*Për pasojë, përzgjedhja e përfituesve sipas kritereve të përcaktuara në këtë vendim, si dhe miratimi dhe alokimi i bursave, është kompetencë e njësive të vetëqeverisjes vendore.*

*Referuar sa më sipër, Këshilli i Bashkisë Korçë me vendimin nr. 86, datë 29.08.2025, ka miratuar dokumentacionin dhe procedurën për përfitimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore parauniversitare.*

*Në shkronjat "h" dhe "i" të pikës 3 të këtij vendimi parashikohet se:*

*h) Në rast se numri i përfituesve, sipas listës së lartpërmendur, është më i lartë se numri i bursave të akorduara nga Ministria e Arsimit, do të përfitojnë bursë ata nxënës që kanë dorëzuar më parë aplikimin pranë shkollës.*

*i) Rast pas rasti, në varësi të buxhetit, Bashkia mund të mbështesë me bursa ata aplikantë të cilët nuk mbulohen nga fondi i miratuar nga Ministria e Arsimit, por që dokumentacioni i dorëzuar prej tyre është i rregullt dhe brenda afatit të dorëzimit.*

*Referuar faqes zyrtare të Bashkisë Korçë, rezulton se dorëzimi i dokumentacionit bëhet pranë sekretarive të shkollave, deri më datën 29 Tetor 2025.*

*Në vijim të këtij njoftimi, shkollat kanë dorëzuar dokumentacionin e plotë brenda afatit të shpallur, edhe për ata nxënës që nuk kanë përfutuar bursa.*

*Lidhur me masat e marra, si dhe analizat afatmesme apo afatgjata të bëra nga Ministria e Arsimit në lidhje me ecurinë e kërkesave për bursa, sikurse kemi bërë me dije edhe me shkresa të mëparshme, ritheksojnë se me vendimin nr. 812, datë 30.12.2025 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projekt Akteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2026", është parashikuar që Ministria e Arsimit do të propozojë për miratim pranë Këshillit të Ministrave projektvendimin "Për disa shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, 'Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike', i ndryshuar".*

*Ky projektvendim është propozuar për miratim me qëllim qartësimin mbi mënyrën e ndarjes së bursave sipas kuotave për nxënësit që plotësojnë kriteret, në zbatim të nenit 19 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, dhe të pikës 2 të nenit 32 të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar.*

*Miratimi i projekt aktit synon të rregullojë çështjet që lidhen me qartësimin e mënyrës së përfitimit të kuotave financiare për rastet kur numri i nxënësve që plotësojnë kriteret është më i lartë se numri i kuotave të miratuara.*

*Në zbatim të vendimit nr. 812, datë 30.12.2025 të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e Programit të Përgjithshëm Analitik të Projekt akteve, që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2026", Ministria e Arsimit ka miratuar urdhrin nr. 8, datë 13.1.2026, "Për ngritjen e grupeve të punës për hartimin e projekt akteve në zbatim të programit të përgjithshëm analitik të projekt akteve për vitin 2026".*

*Grupi i punës është duke hartuar projektvendimin "Për disa shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitim e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike", i ndryshuar", i cili do t'i dërgohet për mendim edhe grupeve të interesit.*

*Në lidhje me rritjen e numrit të aplikimeve për bursa në disa njësi të vetëqeverisjes vendore, përfshirë Bashkinë Korçë, theksohet se dinamika e aplikimeve për bursa mund të ndryshojë nga një vit në tjetrin në varësi të faktorëve socialë dhe ekonomikë. Megjithatë, numri i bursave që mund të miratohet çdo vit është i kushtëzuar nga fondi buxhetor i miratuar për këtë qëllim dhe nga nevoja për të siguruar një shpërndarje të balancuar të këtij fondi në nivel kombëtar.*

*Lidhur me faktin se për vitin shkollor 2025-2026 është miratuar një numër më i ulët bursash krahasuar me vitet paraardhëse (2023-2024 dhe 2024-2025), sqarohet se përcaktimi i kuotave bëhet në funksion të fondit të miratuar në buxhetin e shtetit dhe në bazë të analizës së kërkesave të paraqitura nga të gjitha njësitë e vetëqeverisjes vendore.*

*Në pikën 30 të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, përcaktohet se: "Ministria përgjegjëse për arsimin, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2 të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, jep jo më pak se 1200 (njëmijë e dyqind) bursa ..."*

*Në zbatim të pikës 6 të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, Ministria përgjegjëse për arsimin, në fillim të çdo viti shkollor, në konsultim me institucionet arsimore, harton planin e shpërndarjes së bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilin e dërgon në njësitë e vetëqeverisjes vendore jo më vonë se muaji tetor.*

*Për vitin shkollor 2023-2024, me anë të shkresës nr. 6470/52 prot., datë 20.11.2023 e Ministrisë së Arsimit, me lëndë: "Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2023-2024", është dërguar numri i bursave të miratuara, 3804 në total, nga të cilat 350 për Bashkinë Korçë.*

*Vendimi nr. 666, datë 10.10.2019 i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, sipas pikave 4 dhe 5 të tij, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, i njej të drejtën njërive të vetëqeverisjes vendore që të miratojnë bursa financiare shtesë me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë. Bashkia Korçë për këtë vit shkollor ka miratuar 175 bursa.*

*Për vitin shkollor 2024-2025, nga Ministria e Arsimit janë miratuar 3818 në total. Për Bashkinë Korçë janë miratuar 350 bursa, dërguar me shkresën nr. 7228/37 prot., datë 18.11.2024 e Ministrisë së Arsimit, me lëndë: "Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2024-2025".*

*Vendimi nr. 666, datë 10.10.2019 i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, sipas pikave 4 dhe 5 të tij, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, i njej të drejtën njërive të vetëqeverisjes vendore që të miratojnë bursa financiare shtesë me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë. Bashkia Korçë për këtë vit shkollor nuk ka miratuar bursa.*

*Për vitin shkollor 2025-2026, me anë të shkresës nr. 7094/1 prot., datë 06.11.2025 e Ministrisë së Arsimit, me lëndë: "Dërgohet plani i numrit të bursave për nxënësit të cilët ndjekin studimet në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar, për vitin shkollor 2025-2026", është dërguar numri i bursave të miratuara, 3871 në total, nga të cilat 280 janë miratuar për Bashkinë Korçë.*

*Vendimi nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, sipas pikave 4 dhe 5 të tij, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, i njej të drejtën njërive të vetëqeverisjes vendore që të miratojnë bursa financiare shtesë me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë. Bashkia Korçë për këtë vit shkollor ka miratuar 40 bursa.*

*Sa më sipër, numri i bursave të miratuara nga Ministria e Arsimit në nivel kombëtar ka qenë në rritje. Për rrjedhojë, fakti që në një njësi të caktuar vendore numri i aplikimeve për bursa mund të tejkalojë kuotat e miratuara, nuk përbën në vetvete trajtim të pabarabartë apo diskriminues, për sa kohë që kriteret e përfitimit dhe procedurat e përzgjedhjes zbatohen në mënyrë të njëtrajtshme për të gjithë aplikuesit që ndodhen në kushte të njëjta faktike dhe ligjore.*

*Sa i përket ankesës me nr.29, datë 26.01.2026 e paraqitur nga znj. M.Ç, kundër Ministrisë së Arsimit dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, pranë Bashkisë Korçë, nëpërmjet të cilës pretendohet diskriminimi i fëmijës së mitur V. Ç, nxënëse në shkollën “Asdreni”, për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes ekonomike, bëjmë me dije se Ministria e Arsimit me shkresën nr.1140/1 prot., datë 16.02.2026, të përcjellë pranë Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar (DRAP) Korçë dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar (ZVAP) Korçë-Pustec, ka kërkuar informacion mbi ankesën e paraqitur.*

*DRAP Korçë nga komunikimi në rrugë elektronike ka dërguar sqarimin dhe dokumentacionin e disponuar nga shkolla “Asdreni” Korçë. Nga komunikimi elektronik, shkolla “Asdreni”, Korçë, sqaron si vijon:*

*“Dosjet e aplikuesve janë dorëzuar duke u bazuar në datën e vendosur në Vendimin e Këshillit të Bashkisë që është data 29.10.2025.*

*Dokumentacioni për aplikantët është dorëzuar nga drejtori i shkollës së bashku me mësuesin përgjegjës për pjesën e bursave brenda afateve të përcaktuara nga institucionet përkatëse.*

*Procesverbalet e nxënësve mbajnë datat 16.10.2025 (dy procesverbale) dhe 20.10.2025 (një procesverbal), i cili dhe pse brenda afatit është skualifikuar duke u justifikuar me datën e procesverbalit, i cili mban datën 20.10.2025 duke e penalizuar njërin nga vajzat e familjes Ç, Pra, rritheksojmë procesverbalet mbajnë data të ndryshme. Jo dosjet janë dorëzuar në data të ndryshme.*

*Dosjet me të gjitha dokumentacionet e aplikantëve është dorëzuar pranë NSHMAÇ-së brenda afatit kohor të përcaktuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak, që është data 29.10.2025.*

*Si shkollë disponojmë vetëm procesverbalet individuale të nxënësve të firmosura nga prindërit: pjesa tjetër e dokumentacionit ndodhet në Drejtorinë Mbështetëse (NSHMAÇ)”*

*Sa më sipër, në zbatim të pikës 8 të vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, "Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kritereve për përfitimin e bursave dhe pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar, si dhe format e tjera të përkujdesjes ndaj kategorive të veçanta në institucionet arsimore parauniversitare publike", i ndryshuar, njësitë e vetëqeverisjes vendore, bazuar në planin e përcaktuar sipas pikës 6 të këtij vendimi, me vendim të Këshillit Bashkiak, miratojnë dhënieën e bursave, sipas kritereve të përcaktuara në pikat 2.1, 2.2, 2.3 e 2.4 të këtij vendimi. Për pasojë, përzgjedhja e përfituesve sipas kritereve të përcaktuara në këtë vendim, si dhe miratimi dhe alokimi i bursave, është kompetencë e njësite të vetëqeverisjes vendore.*

*Gjithashtu, Vendimi nr. 666, datë 10.10.2019 i Këshillit të Ministrave, i ndryshuar, sipas pikave 4 dhe 5 të tij, për uljen e nivelit të braktisjes shkollore, për nxënësit që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare nuk ndjekin arsimimin, i njej të drejtën njësite të vetëqeverisjes vendore që të miratojnë bursa financiare shtesë me përfitues nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë”.*

### **III. Vlerësimi i fakteve dhe provave të grumbulluara nga Komisioneri gjatë procesit të shqyrtimit të çështjes**

Në bazë të certifikatës familjare të lëshuar në datën 07.10.2025, nga Zyra e Gjendjes Civile Korçë, rezulton se subjekti ankues, znj. M.Ç, është nëna e fëmijës V.Ç. Vajza e ankueses, V.Ç, është nxënëse në klasën e V-të (pestë), të shkollës 9-vjeçare “Asdreni” Korçë, fakt ky që rezulton i provuar sipas vërtetimit nr.157 prot., datë 16.09.2025, lëshuar nga shkolla 9-vjeçare “Asdreni” Korçë.

Sipas dokumentacionit të administruar, nëna e nxënëses V.Ç, znj. M.Ç trajtohet me pagesë paaftësie, fakt ky që rezulton i provuar sipas vërtetimit të lëshuar në datën 07.10.2025, nga Drejtoria e Kujdesit Social, Bashkia Korçë.

Referuar certifikatës së gjendjes familjare, nxënësja V.Ç figuron si pjesëtare e familjes, e cila përbëhet prej 5 personash, babai z. E.Ç si kryefamiljar, nëna znj. M.Ç, motra H.Ç dhe vëllai F.Ç)

Sipas vërtetimit për përfitimin e ndihmës ekonomike, lëshuar elektronikisht Shërbimi Social Shtetëror në datën 07.10.2025, rezulton se familja është përfituese e ndihmës ekonomike.

Pala ankuese kërkon përfitimin e bursës për vajzën e saj, V.Ç, nxënëse në shkollën 9-vjeçare “Asdreni” Korçë, për vitin shkollor 2025-2026.

Ankesa ka si bazë pretendimin për diskriminim nga ana e Ministrisë së Arsimit dhe Bashkisë Korçë, lidhur me faktin që nxënësja, V.Ç nuk ka rezultuar përfituese e bursës për shkak të aftësisë së kufizuar të njërit nga prindërit/nënës së saj dhe gjendjes ekonomike, si nxënëse që vjen nga familje që trajtohet me ndihmë ekonomike.

Nga provat e administruara rezulton se dokumentacioni i aplikimit u dorëzua nga prindi pranë Shkollës dhe se, u pranua dhe u shqyrtua nga grupi i punës së NSHMAC së bashku me të gjitha aplikimet e tjera të dorëzuara nga nxënësit për bursë.

Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë sqaron se aplikimi për bursë për fëmijën, nxënësen V.Ç, është pranuar dhe shqyrtuar në përputhje me legjislacionin dhe procedurat në fuqi, por nxënësja nuk ka përfituar bursë për vitin shkollor 2025–2026 për shkak të numrit të kufizuar të bursave në raport me aplikimet. Duke arsyetuar se, sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 86, datë 29.08.2025 (pika 3/h), në rast konkurrence mes aplikantëve, përparësi u jepet atyre që kanë dorëzuar më parë dokumentacionin. Kuotat e bursave u mbushën me aplikantët që kishin dorëzuar dokumentacionin deri më datën 17.10.2025.

Sipas Vendimit të Këshillit Bashkiak nr. 86, datë 29.08.2025, aplikimet duhet të dorëzoheshin deri më 31.10.2025 dhe në rast se numri i aplikimeve tejkalonte kuotat e bursave të akorduara nga Ministria e Arsimit, përfituesit zgjidheshin sipas rendit të dorëzimit të aplikimeve me dokumentacion të plotë. Për vitin 2025-2026, Ministria e Arsimit kishte akorduar 280 bursa ndërsa Bashkia Korçë kishte akorduar 40 bursa të tjera, duke e çuar totalin në 320 bursa për këtë vit, ndërsa aplikimet me dokumentacion të rregullt dhe brenda afateve ishin 542 bursa.

Për këtë arsye, nxënësja nuk ishte përfituese e bursës, pasi dokumentacioni i saj ishte dorëzuar në datën 20.10.2025 dhe kuotat e bursave ishin plotësuar me aplikantët që kishin dorëzuar dokumentacionin para kësaj date. Sqarimet nga NSHMAC dhe Ministria e Arsimit konfirmojnë se nuk ka pasur refuzim të aplikimeve, dhe të gjitha procedurat u ndoqën sipas kriterëve dhe kuotave të miratuara ligjërisht.

Ndërkohë, sipas korrespondencës së institucioneve, rezulton se me shkresën nr. 6642 prot., datë 17.10.2025, Ministria e Arsimit i është drejtuar Bashkisë Korçë dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Korçë për marrjen e masave për planifikimin dhe përcaktimin e numrit të bursave për nxënësit që ndjekin arsimin parauniversitar publik për vitin shkollor 2025–2026, brenda datës 27.10.2025.

Me shkresën nr. 844 prot., datë 27.10.2025, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes, Bashkia Korçë i ka kthyer përgjigje Ministrisë së Arsimit, duke bërë të ditur se në kuadër të procesit të aplikimit për bursa janë dorëzuar gjithsej 682 aplikime, nga të cilat 556 aplikime nga nxënës të arsimit parauniversitar (shkollat 9-vjeçare) dhe 126 aplikime nga nxënës të shkollave të mesme. Në këtë përgjigje është specifikuar gjithashtu se aplikimet janë administruar dhe përpunuar sipas procedurave në fuqi, ndërsa bashkëlidhur janë përcjellë listat përkatëse të aplikantëve, të ndara sipas kategorive dhe kriterëve të përcaktuara.

Me shkresën nr. 7094/1 prot., datë 06.11.2025, Ministria e Arsimit i është drejtuar Bashkisë Korçë, duke përcjellë planin e detajuar të bursave të akorduara për këtë njësi vendore për vitin shkollor 2025–2026. Në këtë shkresë përcaktohet numri i përgjithshëm i bursave të miratuara për Bashkinë

Korçë, i cili rezulton të jetë 280 bursa, duke shërbyer si bazë për përzgjedhjen e përfituesve nga strukturat përgjegjëse, në përputhje me kriteret dhe procedurat e përcaktuara në legjislacionin në fuqi.

Me vendimin e Këshillit Bashkiak Korçë nr. 117, datë 27.11.2025, “Për miratimin e bursave për nxënësit e arsimit parauniversitar për vitin shkollor 2025–2026 në institucionet arsimore publike”, është miratuar dhënia e gjithsej 320 bursave, nga të cilat 280 bursa mbulohen nga fondet e Ministrisë së Arsimit, ndërsa 40 bursa financohen nga fondi i Bashkisë Korçë.

Me shkresën nr. 993 prot., datë 03.12.2025, Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes pranë Bashkisë Korçë i është drejtuar Ministrisë së Arsimit, duke kërkuar shtimin e kuotave të bursave për nxënësit, me arsyetimin se numri i aplikimeve të rregullta ka qenë 542, ndërkohë që nga Ministria janë miratuar vetëm 280 bursa dhe nga fondet e Bashkisë janë mbuluar edhe 40 bursa të tjera. Si pasojë, 222 nxënës me aplikime të rregullta kanë mbetur pa u mbuluar me bursë.

Me shkresën nr. 7802/1 prot., datë 15.12.2025, Ministria e Arsimit i ka kthyer përgjigje Bashkisë, ku ndër të tjera thekson se njësia e vetëqeverisjes vendore mund të miratojë dhe shpërndajë bursa edhe nga fondet e veta ose nga fondet buxhetore të përfituara në formën e transfertës së pakushtëzuar.

#### **A. Lidhur me trajtimin e padrejtë, të pabarabartë e të pafavorshëm**

Nëna e fëmijës, nxënëses V.Ç është person që trajtohet me pagesë paaftësie. Znj. M.Ç ka aplikuar për bursë për vajzën e saj, V.Ç, nxënëse në shkollën 9-vjeçare “Asdreni” Korçë, për vitin shkollor 2025–2026, sipas kriterit joekonomik të përcaktuar në VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, për nxënësit e arsimit parauniversitar që plotësojnë kriterin joekonomik.

Ndërkohë ankuesja ka aplikuar për të përfituar këtë bursë, duke dorëzuar dokumentacionin e kërkuar pranë shkollës, por nxënësja nuk rezultoi përfituese për shkak se numri i bursave të akorduara nga Ministria e Arsimit ishte i kufizuar (280 bursa) dhe nga fondi i Bashkisë u akorduan vetëm 40 bursa të tjera, ndërkohë që numri i aplikimeve të rregullta ishte 542. Bazuar në Vendimin e Këshillit Bashkiak nr. 86, datë 29.08.2025, përparësi u jepet aplikimeve të dorëzuara më parë, dhe kuotat u plotësuan me aplikimet e dorëzuara deri më datën 17.10.2025, duke lënë jashtë aplikimin e dorëzuar nga ankuesja më 20.10.2025. Për këtë arsye, nxënësja V.Ç nuk ishte përfituese e bursës për vitin shkollor 2025–2026. Rezulton se, znj. M.Ç, ka përfituar bursë për dy fëmijët e tjerë, sipas kriterit joekonomik, pika 2.3/d, të VKM-së nr.666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, për të cilët sipas informacionit të administruar procesverbali i dorëzimit të dokumentacionit pranë shkollës mbante datën 16.10.2025.

E drejta për arsim, është një e drejtë kushtetuese, e cila duhet të sigurohet mbi baza të barabarta dhe pa diskriminim. E drejta për arsim garantohet edhe në kuadër të marrëveshjeve ndërkombëtare të

cilat vendi ynë i ka ratifikuar duke u bërë kështu pjesë e sistemit të brendshëm ligjor dhe të detyrueshme për t'u zbatuar.

Kështu, në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, parashikohet se:

1. *Kushdo ka të drejtën për arsimim.*
2. .... 3. .... 4. ....
5. *Arsimi i detyrueshëm, si dhe arsimi i mesëm i përgjithshëm në shkollat publike është falas.*

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t'u arsimuar. Konventa mbi të Drejtat e Fëmijës, e cila është ratifikuar nga vendi ynë, sanksionon të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta.

Në nenin 28 të Konventës mbi të Drejtat e Fëmijës<sup>4</sup>, parashikohet se:

1. *Shtetet Palë njohin të drejtën e fëmijës për arsimim dhe, me qëllim që të arrihet kjo e drejtë, hap pas hapi dhe mbi bazën e mundësive të barabarta, në mënyrë të veçantë ata:*

- a) *Bëjnë arsimin fillor të detyrueshëm dhe falas për të gjithë;*
- e) *Marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.*

*Neni 29*

1. *Shtetet Palë u morën vesh që arsimimi i fëmijës të ketë për synim:*

(a) *Të zhvillojë potencialin e plotë të personalitetit, dhuntive dhe aftësive mendore e fizike të fëmijës;*

(b) *Të rrisë respektin për të drejtat e liritë themelore të njeriut dhe për parimet e mishëruara në Kartën e Kombeve të Bashkuara.*

Ligji 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënësi duhet t'i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

Kështu, në ligjin 69/2012, parashikohet se:

*Neni 5. E drejta për arsimim.*

1. *Në Republikën e Shqipërisë garantohet e drejta për arsimimin e shtetasve shqiptarë, të huaj dhe personave pa shtetësi, pa u diskriminuar nga gjinia, raca, ngjyra, etnia, gjuha, orientimi seksual, bindjet politike ose fetare, gjendja ekonomike apo sociale, mosha,*

---

<sup>4</sup> Ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin 7531, datë 11.12.1991

*vendbanimi, aftësia e kufizuar ose për arsye të tjera që përcaktohen në legjislacionin shqiptar.*

*2. Në shkollat publike arsimit të detyrueshëm dhe arsimit të mesëm i lartë janë falas.*

*Neni 6. Parime të përgjithshme.*

*4. Në institucionet arsimore zbatohet parimi i gjithëpërfshirjes së nxënësve.*

*5. Çdo nxënësi i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.*

*6. Nxënësve të familjeve në nevojë, nxënësve me aftësi të kufizuara dhe atyre me vështirësi në të nxënë u ofrohet përkujdesje e posaçme, sipas përcaktimeve në këtë ligj.*

*Neni 19. Përkujdesje për kategori të veçanta të nxënësve.*

*Kategorive të veçanta të nxënësve u sigurohet kujdes i posaçëm nga shteti. Format dhe kriteret e përkujdesjes përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.*

*Neni 28. Njësia bazë e qeverisjes vendore.*

*1. Njësia e vetëqeverisjes vendore, mbështetur në propozimet e institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe këshillat e mësuesve të institucioneve, sipas kriterëve të miratuara në këshillat e njësive të vetëqeverisjes vendore, mbështet: a) nxënësit e familjeve në nevojë; b) nxënësit me arritje të shkëlqyera; c) punonjësit e institucioneve arsimore për zhvillimin e tyre profesional dhe për zhvillimin e kurrikulës; ç) pajisjen e institucioneve arsimore me mjete mësimore; d) nxënësit me aftësi të kufizuara.*

*Në zbatim dhe të legjislacionit të sipërcituar, Këshilli i Ministrave miratoi Vendimin nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, e ndryshuar.*

*Në pikën 2 të këtij vendimi përcaktohej se:*

*“2. Nxënësit, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar me kohë të plotë dhe arsimin e mesëm profesional në institucionet arsimore publike, përfitojnë bursë brenda kuotave dhe kriterëve, si më poshtë vijon:*

#### *2.1 Kriteri ekonomik:*

*a) nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët ndjekin procesin mësimor në largësinë mbi 5 km nga vendbanimi i përhershëm i tyre, që plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi, dhe që akomodohen në konvikte publike;*

*b) nxënësit e arsimit parauniversitar, të cilët banojnë në zonat rurale që nuk kanë shkollë 9-vjeçare brenda rrezes prej 5 km, të cilët plotësojnë kriterin ekonomik, sipas pasqyrës nr. 1, dhe që akomodohen në konvikte publike;*

c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, me ndikim në uljen e nivelit të “braktisjes shkollore”, që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë.

2.2 Kriteri i rezultateve të arritura:.....

2.3 Kriteri joekonomik:

- a) nxënësit, të cilët kanë përfitur statusin e jetimit;
- b) nxënësit, të cilët kanë humbur kujdestarinë prindërore me vendim gjykate të formës së prerë;
- c) nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor të invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik;
- ç) nxënësit, të cilët gëzojnë statusin ligjor që nuk shikojnë apo nuk dëgjojnë;
- d) nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit;
- dh) nxënësit e pakicës kombëtare rome dhe egjiptiane, të cilët regjistrohen dhe ndjekin arsimin e mesëm profesional;
- e) nxënësit, të cilët janë identifikuar dhe trajtuar si viktimat të trafikut të qenieve njerëzore dhe kanë humbur kujdesin prindëror;
- ë) nxënësit, fëmijë të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës, Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Shërbimit të Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, Forcave të Armatosura, Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Policisë së Burgjeve, të cilët kanë humbur jetën në krye dhe për shkak të detyrës;
- f) nxënëset (vajza), të cilat ndjekin drejtimet mësimore mekanikë, elektroteknikë, elektronikë, përpunim druri, gjeodezi, shërbim mjete transporti, termo-hidraulikë;
- g) nxënësit me një prind.

Në fillim të çdo viti shkollor, por jo më vonë se muaji nëntor i çdo viti, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Mbrojtjes, Shërbimi Informativ i Shtetit dhe institucionet e përkujdesjes sociale rezidenciale publike, për këto kategori nxënësish, duhet të dërgojnë në institucionet arsimore ku ata ndjekin procesin mësimor si dhe në njësitë e vetëqeverisjes vendore përkatëse listën e nxënësve përfitues sipas pikës 2.3 të këtij vendimi.

Qëllimi i përbashkët i akteve ligjore dhe nënligjore të sipërpërmendura është që nëpërmjet tyre të garantohet e drejta e fëmijës për arsim.

Komisioneri konstaton se nxënësja V.Ç plotëson kriterin joekonomik, sipas VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar, për përfitimin e bursës për nxënësit e arsimit parauniversitar, kriterin 2.3/d, i cili garanton përfitimin e bursës për nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit. Mospërfshirja në listën e përfituesve për vitin shkollor 2025–2026 e ka ekspozuar vajzën e ankueses, nxënësen V.Ç, ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.

Sa më sipër, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi ka konstatuar se nga ana e Bashkisë Korçë është pretenduar se shkak i mospërfitimit të bursës nga nxënësja ishte numri i kufizuar i

kuotave të vëna në dispozicion nga Ministria e Arsimit dhe fondet e Bashkisë, i cili ishte më i vogël se numri i aplikantëve që plotësonin kriteret e përfitimit.

Komisioneri vlerëson se për sa kohë që aplikimi i subjektit ankues plotësonte të gjitha kriteret ligjore të parashikuara në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi për përfitimin e kësaj burse, pretendimi i institucioneve për mungesën e fondeve në dispozicion për të garantuar këtë të drejtë nuk mund të justifikohet dhe ngarkon institucionet me përgjegjësi.

Në VKM nr. 666, datë 10.10.2019 *“Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet publike”*, i ndryshuar me VKM nr. 511, datë 27.07.2022 pika 10 parashikohet se: *“Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, njësitë e vetëqeverisjes vendore, drejtoritë rajonale të arsimit parauniversitar, zyrat vendore të arsimit parauniversitar, si dhe ofruesit e arsimit të mesëm profesional publik për zbatimin e këtij vendimi.”*

Sa më sipër, institucionet qendrore dhe ato vendore duhet të bashkëpunonin me njëra tjetrën për të bërë të mundur plotësimin e parashikimeve ligjore sa i takon çështjes objekt ankese, pasi kjo problematikë sipas dokumentacionit të vënë në dispozicion nga ana e Bashkisë Korçë ekziston dhe për një numër të konsiderueshëm aplikantësh të tjerë që plotësonin kriteret ligjore dhe që iu është mohuar kjo e drejtë.

Komisioneri konstaton që përveç Bashkisë Korçë dhe Ministria e Arsimit nuk ka ndërmarrë masa konkrete për zgjidhjen e kësaj shtate dhe pse Bashkia ia ka përcjellë këtë shqetësim.

Ministria e Arsimit është shprehur që duhet nga ana e Këshillit Bashkiak Korçë, të merren masa për zgjidhjen e këtij problemi, por referuar VKM-së Nr. 511, datë 27.7.2022 *“Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 666, datë 10.10.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”*, të ndryshuar, kjo është një bursë e cila ofrohet nga ana e Ministria e Arsimit.

Sipas pikës 30, në VKM nr. 666, datë 10.10.2019, ndryshuar me VKM nr. 511, datë 27.07.2022: *“Ministria përgjegjëse për arsimin, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, jep jo më pak se 1200 (një mijë e dyqind) bursa.”*

Ndërmarrja e Shërbimeve Mbështetëse të Arsimit dhe Çerdhes<sup>5</sup> ka sqaruar se aplikimi është pranuar dhe shqyrtuar sipas procedurave ligjore, por nxënësja V.Ç nuk ka përfituar bursë për shkak të numrit të kufizuar të bursave. Për vitin shkollor 2025-2026, Ministria e Arsimit kishte akorduar 280 bursa për Bashkinë Korçë, ndërsa Bashkia kishte akorduar 40 të tjera, duke çuar totalin në 320 bursa.

---

<sup>5</sup> Referuar shkresës së MAS.

Numri i aplikimeve të rregullta brenda afatit ishte 542, prandaj kuotat u mbushën nga nxënësit që kishin dorëzuar dokumentacion deri më 17.10.2025, ndërsa aplikimi për nxënësen V.Ç, rezultoi të jetë dorëzuar pas kësaj date, konkretisht në datë 20.10.2025

Ankuesja znj. M.Ç, pretendon se ka bërë aplikimin dhe ka dorëzuar dokumentacionin në të njëjtën datë për të tre fëmijët. Rezulton se, procesverbali për dorëzimin e dokumentacionit për aplikim për bursë për V.Ç, i cili është nënshkruar nga znj. Ç mban datën 20.10.2025. Ndërkohë, sipas informacionit të vendosur në dispozicion nëpërmjet shkresës nr. 1025/1 prot., datë 12.03.2026, të MA, rezultoi se, znj. Ç, është paraqit në shkollë dhe ka dorëzuar dokumentacionin në datën 16.10.2025. Sipas shpjegimeve të dhëna nga shkolla, mësuesja kujdestare e cila ka qenë në grupin e punës për administrimin dhe grumbullimin e dokumentacionit për klasën e saj, se përse procesverbali nuk mbante të njëjtën datë me fëmijët e tjerë të ankuseses, ka sqaruar se data e përfundimit të dorëzimit të dokumentacionit ka qenë 29.10.2025 dhe se ka grumbulluar dokumentacionin në atë datë, pasi priste prindër të tjerë të sillnin dokumentacionin, duke respektuar afatin ligjor për dorëzimin e procesverbaleve. Gjithashtu, sipas *e-mailit* të datës 18.2.2026, të shkollës Asdreni, Korçë, sqarohet se procesverbalet mbajnë data të ndryshme dhe jo dosjet janë dorëzuar në data të ndryshme.

Komisioneri konstaton se, nxënësja V.Ç plotëson kriterin ligjor për përfitimin e bursës, sipas pikës 2.3/ d, të VKM nr. 666, datë 10.10.2019, si fëmijë e personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit. Pretendimi i Bashkisë Korçë se mospërfitimi lidhet me kuotat e limituara nuk mund të justifikohet ligjërisht, pasi institucionet kanë përgjegjësi që të garantojnë të drejtën për përfitim, të nxënësve që plotësojnë kriteret.

Rezulton se, për vajzën e ankuseses është plotësuar aplikimi vetëm për kriterin joekonomik, sipas pikës 2.3/d, si fëmijë e personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit. Nga aktet e vendosura në dispozicion rezultoi se, ankuesja ka depozituar dhe vërtetimin familja e saj trajtohet me ndihmë ekonomike, por nga ana e shkollës nuk është plotësuar procesverbal i veçantë për aplikimin edhe sipas kriterit ekonomik pika 2.1/c, të VKM-së. Vërtetimi që familja e nxënëses trajtohet me ndihmë ekonomike është administruar edhe nga NSHMAÇ gjatë shqyrtimit të aplikimeve të tjerëve, por nuk rezultoi që të jete kryer asnjë vlerësim.

Komisioneri vlerëson se, nxënësja V.Ç, plotëson edhe kriterin e parashikuar nga pika 2.1.c, në kuadër të kriterit ekonomik të VKM-së, si fëmijë i një familjeje në nevojë, pasi bazuar në provat e administruara rezultoi se familja e saj trajtohet me ndihmë ekonomike nga Bashkia Korçë. Në praktikën e tij, Komisioneri ka vlerësuar se, fëmijët e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, konsiderohen fëmijë që vijnë nga familje në nevojë dhe plotësojnë kriterin e parashikuar nga pika 2.1.c të VKM nr.666, datë 10.10.2019, i ndryshuar.<sup>6</sup>

---

<sup>6</sup> Shiko:Vendimi nr.112, datë 06.05.2025; Vendimi nr. 149, datë 21.05.2024; Vendimi Nr.141, datë 20.05.2024; Vendimi nr. 75, datë 07.04.2025.

Komisioneri konstaton se, për sa kohë nxënësi/ja plotëson kriteret ligjore për përfitimin e bursës, ai ka të drejtën për përfitimin e kësaj burse. Duke qenë se kjo e drejtë është e parashikuar qartë në legjislacionin në fuqi, institucionet përgjegjëse, si Bashkia Korçë dhe Ministria e Arsimit, kanë detyrimin e drejtpërdrejtë dhe të detyrueshëm për të siguruar realizimin e saj. Çdo refuzim ose mospërfitim i saj, për shkak të kufizimit të kuotave ose arsyeve administrative, përbën një shkelje të të drejtave të fëmijës dhe detyrimeve ligjore të institucioneve, duke e ekspozuar nxënësen ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë.

Pra, Komisioneri vlerëson se refuzimi i bursës për nxënësen V.Ç është i paarsyeshëm dhe bie ndesh me legjislacionin në fuqi, pasi ajo plotëson kriterin joekonomik 2.3/ d dhe kriterin ekonomik 2.1.c, statusin si fëmijë i familjes në nevojë, sipas VKM nr.666, datë 10.10.2019, i ndryshuar, ndërkohë që dokumentacioni ishte i plotë dhe në përputhje me procedurat e përcaktuara.

Për sa më lart, Komisioneri arrin në përfundimin se, mospërfshirja e emrit të fëmijës V.Ç në listën e përfituesve të bursës për vitin shkollor 2025-2026 nga ana e Bashkisë Korçë, e ka ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, duke ia mohuar të drejtën për të përfituar këtë bursë sipas kriterëve joekonomike të pikës 2.3/d “*Nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit*” dhe kriterin ekonomik, pika 2.1/c “*c) nxënësit, fëmijë të familjeve në nevojë, me ndikim në uljen e nivelit të “braktisjes shkollore”, që janë regjistruar në arsimin bazë, por, në pamundësi financiare, nuk ndjekin arsimin bazë*”, të Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, “*Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimin parauniversitar në institucionet arsimore publike*”, i ndryshuar.

Gjithashtu, Komisioneri arrin në përfundimin se, për arsye se nga ana e Ministrisë së Arsimit nuk është ndërmarrë asnjë veprim për zgjidhjen e situatës jo vetëm për vitin shkollor 2025-2026, por edhe pasi është ngritur shqetësimi nga ana e Bashkisë Korçë për të njëjtën çështje, nxënësjja V.Ç është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë nga MA, duke ia mohuar të drejtën për të përfituar këtë bursë sipas kriterëve joekonomike të pikës 2.3/d dhe kriterit ekonomik të pikës 2.1/c, të Vendimit nr. 666, datë 10.10.2019 të Këshillit të Ministrave, “*Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimin parauniversitar në institucionet arsimore publike*”, i ndryshuar.

## **B. Shkaku i mbrojtur.**

Në bazë të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë (neni 18 (2)), askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore.

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ-ja), garanton të drejtën për të mos u diskriminuar bazuar në një listë jo shteruese shkaqesh, duke parashikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë mbrojtjen nga diskriminimi për shkaqe si seksi, raca, ngjyra, gjuha, feja, mendimet politike ose çdo mendim tjetër, origjina kombëtare ose shoqërore, përkatësia në një minoritet kombëtar, pasuria, lindja ose çdo status tjetër.

Ligji nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, rregullon në mënyrë të drejtpërdrejtë zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit për shkak të *gjendjes familjare dhe përkatësisë prindërore*, të pretenduar nga pala ankuese si shkaqe diskriminuese, duke parashikuar në nenin 1, të tij se : “*Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë dhe mosdiskriminimit në lidhje me racën, etninë, ngjyrën, gjuhën, shtetësinë, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, gjininë, identitetin gjinor, orientimin seksual, karakteristikat e seksit, jetesën me HIV/AIDS, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicionet gjenetike, pamjen e jashtme, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.*”

Bazuar në shkaqet e mbrojtura të përcaktuara në nenin 1, të ligjit nr. 10221/2010 “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, të ndryshuar, si dhe duke ju referuar përkufizimit të diskriminimit që ky ligj ka bërë në nenin 3, të tij, jo çdo diferencë në trajtim apo trajtim më pak i favorshëm gëzon mbrojtje nga ligji. Mbrojtja nga diskriminimi sipas ligjit, garantohet vetëm për ato diferenca në trajtim apo trajtime më pak të favorshme, që kanë për bazë një nga shkaqet e mbrojtura.

Në rastin në fjalë, pretendohet se nxënësja V.Ç, fëmija i ankuseses znj. M.Ç, është diskriminuar për shkak të aftësisë së kufizuar dhe gjendjes ekonomike, duke i mohuar të drejtën e garantuar ligjërishit për përfitimin e bursës për nxënësit e arsimit parauniversitar.

*Në parim*, në lidhje me shkakun e pretenduar të diskriminimit, pala ankuese duhet të provojë në radhë të parë se shkakun e pretenduar prej saj është një shkak që gëzon mbrojtje sipas ligjit dhe në radhë të dytë duhet të provojë ekzistencën e tij.

Komisioneri vlerëson se “aftësia e kufizuar” dhe “gjendja ekonomike” janë shkaqe të mbrojtura, pasi parashikohen si i tilla nga neni 1, i LMD.

Sipas Vërtetimit të Drejtorisë së Kujdesit Social, të Bashkisë Korçë, vërtetohet se znj. M.Ç është përfituese e pagesës së aftësisë së kufizuar.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, kategoria e nxënësve që gëzojnë statusin ligjor si fëmijë të personit që gëzojnë statusin e invalidit, janë kategori që e mbartin shkakun e mbrojtur. Për rrjedhojë, Komisioneri vlerëson se, pretendimi për diskriminim duhet të shqyrtohet bazuar në shkakun e *aftësisë së kufizuar*, pasi konsiderohet i provuar mbështetur në provat dhe faktet e administruara.

*Gjendja ekonomike*, si shkak i ndaluar diskriminimi, kryesisht lidhet me individë, grupe individësh apo grupe shoqërore, të cilët janë në pamundësi ekonomike për të përballuar një jetesë dinjitoze dhe kjo pamundësi reflekton pastaj në braktisjen e shkollës ose në arritjet e nxënësve.

Komenti i Përgjithshëm nr. 20 “*Mosdiskriminimi në të drejtat ekonomike, sociale dhe kulturore*”, i Komitetit për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore, i Kombeve të Bashkuara, parashikon: “*Situata sociale dhe ekonomike e një personi kur jeton në varfëri ose është i pastrehë mund të rezultojë në diskriminim të përhapur, stigmatizim dhe stereotipe negative që mund të çojnë në refuzimin ose aksesin e pabarabartë për të njëjtën cilësi të arsimit dhe kujdesit shëndetësor si të tjerët, si dhe mohim ose akses të pabarabartë në vendet publike*”.

Ligji nr. 57/2019 “*Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë*” përcakton se: “*Ndihma ekonomike*”, është mbështetja me para, që u jepet familjeve dhe individëve në nevojë, sipas përcaktimeve të bëra në këtë ligj, dhe se, përfituesit e ndihmës ekonomike janë: “.....a) *familjet në nevojë, që nuk kanë të ardhura ose kanë të ardhura të pamjaftueshme.*”

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, kategoria e familjeve që trajtohen me ndihmë ekonomike, dhe kanë fëmijë që ndjekin arsimin parauniversitar, është kategori e familjeve në nevojë që e mbartin shkakun e mbrojtur.

Ankuesja ka depozituar dokumentacion me anën e të cilit provon shkakun e gjendjes ekonomike dhe konkretisht vërtetimin për përfitimin e ndihmës ekonomike, ku vërtetohet se familja e nxënësës Veljona Ç, trajtohet me ndihmë ekonomike.

Sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, pretendimi për diskriminim duhet të shqyrtohet bazuar në shkakun e *gjendjes ekonomike*, pasi konsiderohet i provuar mbështetur në provat dhe faktet e administruara.

### **C. Lidhja e trajtimit të pafavorshëm me shkakun e mbrojtur**

Parimi i barazisë dhe i mosdiskriminimit, sanksionohet nga Kushtetuta si një parim i përgjithshëm që përshkon të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, prandaj ai duhet të gjejë shprehjen e tij në të gjithë legjislacionin shqiptar, si dhe të zbatohet nga të gjithë, si nga institucionet edhe nga individët. Neni 18, i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë ku sanksionohet ky parim parashikon: “1. Të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. 2. Askush nuk mund të diskriminohet padrejtësisht për shkaqe të tilla si gjinia, raca, feja, etnia, gjuha, bindjet politike, fetare a filozofike, gjendja ekonomike, arsimore, sociale ose përkatësia prindërore. 3. Askush nuk mund të diskriminohet për shkaqet e përmendura në paragrafin 2, nëse nuk ekziston një përlligje e arsyeshme dhe objektive”.

Gjykata Kushtetuese në disa vendime të saj ka interpretuar nenin 18 të Kushtetutës, si dhe ka theksuar se parimi i barazisë synon që të gjithë të jenë të barabartë në ligj dhe përpara ligjit, jo vetëm në të drejtat themelore të parashikuara në Kushtetutë por edhe në të drejtat e parashikuara nga ligjet e tjera në fuqi. Gjykata është shprehur se: “*Barazia në ligj dhe para ligjit nuk do të thotë që të ketë zgjidhje të njëllota për individë ose kategori personash që janë në kushte objektivisht të*

*ndryshme. Barazia përpara ligjit dhe në ligj presupozon barazinë e individëve që janë në kushte të barabarta”, si dhe “Vetëm në raste përjashtimore dhe për shkaqe të arsyeshme dhe objektive mund të përliqjet trajtimi i ndryshëm i kategorive të caktuara që përfitojnë nga kjo e drejtë” (shih vendimet nr. 39, datë 16.10.2007, nr. 4 datë 12.02.2010, të Gjykatës Kushtetuese).*

Neni 14 i Konventës Evropiane për Drejtat e Njeriut (KEDNJ), ndalon diskriminimin në gëzimin e të drejtave dhe lirive të përcaktuara, ndërkohë që Protokollin 12-të të KEDNJ-së, i cili është ratifikuar nga Shqipëria, ndalon diskriminimin në lidhje me “gëzimin e çdo të drejte të parashtruar nga ligji” dhe kështu ofron mbrojtje më të madhe se sa neni 14, i cili lidhet vetëm me të drejtat e garantuara nga KEDNJ-ja. Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut (GJEDNJ), në mënyrë të vazhdueshme ka interpretuar se “diskriminimi” do të thotë që të trajtosh ndryshe pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, persona të cilët ndodhen në situata të ngjashme dhe diferenca në trajtim, nuk bazohet në ndonjë justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, domethënë, se trajtimi i diferencuar nuk ndjek një qëllim legjitim dhe nuk ekziston një marrëdhënie e arsyeshme të proporcionalitetit ndërmjet mjeteve të përdorura dhe qëllimit që synohet të realizohet.

Sipas GJEDNJ-së, e drejta për të mos u diskriminuar e garantuar nga KEDNJ, gjithashtu cenohet kur pa një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm shtetet dështojnë që të trajtojnë ndryshe personat situata e të cilëve është objektivisht e ndryshme<sup>7</sup>. GJEDNJ, shprehet se, ndalimi që rrjedh nga neni 14 do të krijojë detyrime pozitive për shtetet kontraktuese për të bërë dallimet e nevojshme ndërmjet personave ose grupeve, rrethanat e të cilëve janë në mënyrë të rëndësishme dhe domethënëse të ndryshme<sup>8</sup>. Për më tepër, GJEDNJ, shprehet se, neni 14 nuk e ndalon një shtet anëtar që t'i trajtojë grupet ndryshe për të korrigjuar “pabarazitë faktike” ndërmjet tyre; në të vërtetë, në rrethana të caktuara, dështimi në përpjekje për të korrigjuar pabarazinë nëpërmjet trajtimit të ndryshëm, mund të shkaktojë në vetvete një shkelje të nenit 14<sup>9</sup>.

Në nenin 3, pika 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Diskriminim*” është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim ose pasojë pengesën ose bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët të të drejtave e lirive themelore të njohura nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe nga ligjet në fuqi”.

Në bazë të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, jo çdo dallim apo ndryshim i trajtimit konsiderohet diskriminim. Në bazë të nenit 6, të LMD, përcaktohet se: “*Ndalimi i diskriminimit i përshkruar nga ky ligj nuk zbatohet në rastet kur ka një qëllim*

<sup>7</sup> Shih: Çështja Thlimmenos kundër Greqisë [GC], nr. 34369/97, prg. 44, GJEDNJ 2000-IV; Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

<sup>8</sup> Shih: Çështja J.D dhe A kundër Mbretërisë së Bashkuar, nr.32949/17 dhe 34614/17, prg. 84, 24 tetor 2019.

<sup>9</sup> Shih: Çështjen Horváth dhe Kiss kundër Hungarisë, nr. 11146/11, datë 29.01.2013, prg. 101; Çështjen Thlimmenos, cituar më lart, prg. 44; Çështjen D.H. dhe të tjerët kundër Republikës Çeke (GC), nr.57325/00, GJEDNJ 2007-IV, prg.175).

*objektivisht të justifikueshëm dhe të përligjur në bazë të Kushtetutës, të marrëveshjeve apo akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë dhe legjislacioni në fuqi”.*

Barra e provës në çështjet e diskriminimit është objekt i një rregullimi të posaçëm. Ky rregullim i posaçëm në lidhje me barrën e provës pasqyrohet në nenin 33, pika 7/1 të LMD-së ku sanksionohet se : “7/1. Në rastet kur pala ankuese paraqet fakte mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër, kundër së cilës është paraqitur ankesa, detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim”. Një rregullim të posaçëm të barrës së provës për çështjet e diskriminimit parashikohet nga Kodi i Procedurave Administrative, në nenin 82, pika 2, të të cilit, përcaktohet si vijon: “2. Në rastet kur pala paraqet prova mbi të cilat bazon pretendimin për sjelljen diskriminuese dhe në bazë të të cilave mund të prezumohet se ka pasur diskriminim, pala tjetër dhe/ose organi publik detyrohet të provojë se faktet nuk përbëjnë diskriminim, pavarësisht nga detyrimi i organit publik për të vënë në dispozicion të palëve provat e zotëruara prej saj”.

Duke qenë se pala kundër të cilës drejtohet ankesa disponon gjithë informacionin dhe dokumentacionin e nevojshëm për të provuar bazueshmërinë e pretendimeve, legjislacioni e ka zhvendosur barrën e provës palës kundër të cilës është paraqitur ankimi, kur vihet re se prima facie është ngritur një pretendim për diskriminim. Pala kundër të cilës është paraqitur ankesa ka barrën e provës të provojë se trajtimi i diferencuar nuk është diskriminues.

Sa më sipër, fillimisht duhet të krijohet një prezumim i diskriminimit (diskriminimi *prima facie*), barra më pas kalon tek pala e akuzuar, e cila duhet të tregojë se ndryshimi në trajtim nuk është diskriminues. Kjo mund të bëhet:

1. Ose duke vërtetuar se nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të mbrojtur dhe trajtimit të pafavorshëm.
2. Ose duke demonstruar që megjithëse ky trajtim është i lidhur me shkakun e pretenduar, ka një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Nëse subjekti që pretendohet se ka konsumuar sjelljen diskriminuese nuk është në gjendje të provojë njërën nga të dyja, atëherë do të jetë përgjegjës për diskriminimin.<sup>10</sup>

Komisioneri çmon të nevojshme të theksoj se, është pikërisht bazuar në standardin e mësipërm të të provuarit, që do të shqyrtojë dhe do të konkludojë në lidhje me bazueshmërinë e pretendimeve për diskriminim të parashtruara në këtë ankesë.

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështjeje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm në bazë të të cilit fëmija Veljona Ç, rezulton përfitues dhe faktit që:

---

<sup>10</sup> [https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra\\_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018\\_en.pdf](https://fra.europa.eu/sites/default/files/fra_uploads/fra-2018-handbook-non-discrimination-law-2018_en.pdf), fq.232.

- Nxënësja Veljona Ç plotëson kriterin joekonomik sipas pikës 2.3/d, si fëmijë e personit që gëzon statusin e invalidit dhe kriterin ekonomik sipas pikës 2.1/c, si fëmijë që vjen nga familjeve në nevojë, të VKM-së nr. 666/2019, të ndryshuar;
- Për vitin shkollor 2025–2026, aplikimi i tyre u dorëzua brenda afatit të përcaktuar (pranuar nga të gjitha palët)
- Aplikimi i nxënësës Veljona Ç për vitin 2025-2026 përmbushte dhe mbarte të gjitha informacionet dhe dokumentacionin e kërkuar nga administrata, duke përmbushur të gjitha kriteret ligjore dhe administrative të VKM-së nr. 666/2019 (pika 2.3/d dhe 2.1/c)
- Për shkak të mungesës së fondeve të mjaftueshme dhe kuotave të limituara të vendosura nga Ministria e Arsimit dhe Bashkia Korçë, ajo nuk ka përfituar bursën për vitin shkollor 2025–2026.
- Kjo situatë e ka ekspozuar nxënësen ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, duke i mohuar të drejtën për të përfituar bursën sipas kriterëve ligjore.

Në analizë sa më sipër, Komisioneri vlerëson se jemi para situatës së prezumimit të diskriminimit të nxënësës Veljona Ç, në lidhje me mosdhënien e bursës për vitin shkollor 2025-2026, nga ana e Bashkisë Korçë dhe Ministrisë së Arsimit edhe pse plotësohen kriteret sipas VKM-së nr. 666/2019 të ndryshuar, dhe si pasojë barra e provës bie mbi këto subjekte.

Në këto kushte, për të vërtetuar të kundërtën, Bashkia Korçë dhe Ministria e Arsimit duhet të përmbushnin dy kushtet e përmendura më sipër.

Në analizë të fakteve dhe provave të administruara gjatë procedurës hetimore, rezultoi se:

- Sipas pikës 30 në VKM nr. 666, datë 10.10.2019, të ndryshuar parashikohet: “Ministria përgjegjëse për arsimin, për të gjitha kategoritë e nxënësve, të cilët ndjekin arsimin parauniversitar, të parashikuara në pikën 2, të këtij vendimi, pa përfshirë nxënësit që ndjekin shkollat profesionale, jep jo më pak se 1200 (një mijë e dyqind) bursa.” Kjo parashikon një përgjegjësi të qartë ligjore të Ministrisë për ofrimin e bursave për nxënësit në pamundësi financiare.
- Bashkia Korçë, në zbatim të ligjit nr. 69/2012 dhe VKM nr. 666/2019, të ndryshuar ka përgjegjësi të mbështesë nxënësit e familjeve në nevojë, duke administruar dhe ndihmuar në shpërndarjen e bursave në nivel lokal. Për vitin shkollor 2025–2026, Bashkia ka përcaktuar një kuotë prej 40 bursash, ndërkohë që për vitin 2024–2025 nuk ka dhënë asnjë bursë nga fondet e veta, duke lënë jashtë çdo mundësie aplikuesit.
- Nga shqyrtimi i trendit të aplikimeve dhe të dhënave të administruara, rezulton se numri i aplikimeve për bursa në vitet e fundit, ka qenë në rritje, por as Bashkia Korçë dhe as Ministria e Arsimit nuk kanë ndërmarrë masa për të rritur kuotat apo për të siguruar që të gjitha aplikimet që plotësojnë kriteret ligjore të marrin përfitimin. Kjo mungesë veprimi ka krijuar një situatë të përsëritur të trajtimit të padrejtë dhe të pabarabartë për nxënësit.

- Nga ana e Ministrisë së Arsimit, nuk është ndërmarrë asnjë veprim për zgjidhjen e situatës jo vetëm për vitin mësimor 2025-2026, por edhe pasi është ngritur ky shqetësim nga ana e Bashkisë Korçë.
- Për rrjedhojë, mospërfshirja e aplikimit të nxënëses Veljona Ç, e cila plotëson kriterin joekonomik sipas pikës 2.3/d dhe kriterin ekonomik sipas pikës 2.1/c, të VKM nr. 666/2019, të ndryshuar, për përfitimin e bursës, tregon një trajtim të padrejtë dhe të pabarabartë, duke shkelur të drejtën kushtetuese për arsimim dhe detyrimet ligjore të institucioneve përgjegjëse për garantimin e barazisë në aksesin në bursa.

Komisioneri vlerëson se nga ana e Bashkisë Korçë dhe Ministria e Arsimit nuk u arrit të provohej:

1. Që nuk ka ndonjë lidhje shkakësore midis shkakut të pretenduar nga subjekti ankues, dhe trajtimit të pafavorshëm nga ana e Bashkisë Korçë dhe Ministrisë së Arsimit të konstatuar edhe nga Komisioneri në këtë vendim.
2. Që veprimet dhe mosveprimet e Bashkisë Korçë dhe Ministrisë së Arsimit kundrejt subjektit ankues, kanë një justifikim të arsyeshëm dhe objektiv.

Komisioneri vlerëson se, qëllimi i VKM-së nr. 666/2019, të ndryshuar, është ndër të tjera të mbështesë financiarisht, kategori përfituese të veçantë, si: familjet që trajtohen me ndihmë ekonomike; nxënësit, fëmijë të personit/personave që gëzojnë statusin e invalidit apo fëmijë me aftësi të kufizuara, në mënyrë që këtyre fëmijëve tu garantohet e drejta për arsimim.

E drejta për arsim, është një e drejtë themelore e njeriut, e sanksionuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe Shteti ka detyrimin që jo vetëm ta parashikojë, por edhe ta përmbushë këtë të drejtë duke e garantuar atë. Detyrimi për të përmbushur do të thotë që shteti duhet të marrë masa pozitive për të siguruar dhe lehtësuar gëzimin e të drejtave, sidomos për grupet shoqërore më të pamundura, të cilat në të kundërt, nuk do të kenë mundësi të kenë qasje në regjistrimin apo ndjekjen e arsimit.

Fëmija si çdo qenie njerëzore është bartës i të drejtave dhe si i tillë ka të drejtën për t'u arsimuar. Konventa Mbi të Drejtat e Fëmijës, e cila është ratifikuar nga vendi ynë, sanksionon të drejtën e fëmijës për t'u arsimuar mbi bazën e mundësive të barabarta dhe shtetet palë duhet të marrin masa për të inkurajuar frekuentimin e rregullt të shkollës dhe uljen e përqindjes së braktisjes së shkollës.

Ligji 69/2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka si qëllim garantimin e të drejtës kushtetuese për arsimim, sanksionon se, e drejta për arsimim garantohet pa u diskriminuar. Çdo nxënës duhet t'i sigurohet e drejta për arsimim cilësor, si dhe shanse të barabarta për arsimim.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, Bashkia Korçë dhe Ministria e Arsimit për të garantuar të drejtën për arsim të të gjithë fëmijëve, të cilët plotësonin kriteret respektive të parashikuara në VKM duhet të kishte parashikuar trajtimin me bursë të të gjithë fëmijëve që i plotësonin kushtet për përfitimin e saj.

Pra sa më sipër, vajza e ankueses, nxënësja Veljona Ç, është vënë në pozita diskriminuese, për shkak të aftësisë së kufizuar të nënës së saj dhe gjendjes ekonomike të familjes së saj.

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026<sup>11</sup>, ka si vizion të saj: “*Sistem arsimor gjithëpërfshirës dhe i bazuar në parimet e barazisë dhe mësimin gjatë gjithë jetës, që mundëson formimin cilësor të të gjithë individëve, duke kontribuar në mirëqenien personale të tyre, si dhe në forcimin e demokracisë dhe integrimin e vendit në Bashkimin Evropian*”.

Strategjia Kombëtare për Arsimin 2021-2026, ndër objektivat e saj specifike ka parashikuar dhe objektivin specifik A.2, ku citohet: “*Sigurimi i mirëqenies sociale, emocionale dhe fizike të të gjithë nxënësve për të ulur braktisjen dhe për t’u mundësuar nxënësve të arrijnë potencialin e tyre të plotë;... ”.*

Një dokument tjetër strategjik i miratuar nga qeveria shqiptare me VKM-në Nr. 152, datë 13.03.2024, është dhe Strategjia Kombëtare e Mbrojtjes Sociale 2024-2030. Kjo strategji synon: “*... të përmirësojë mirëqenien fizike, shoqërore dhe ekonomike të individëve, fëmijëve dhe familjeve, veçanërisht të atyre në kushte sociale ose ekonomike të pafavorizuara, duke garantuar shanse të barabarta dhe parimet e drejtësisë sociale. Strategjia synon reduktimin e varfërisë, sidomos varfërisë ekstreme, duke garantuar një jetesë dinjitoze për familjet/individin dhe fëmijët. Varfëria do të ulet, duke nxitur zhvillimin e kapaciteteve dhe aftësive të tyre nëpërmjet adresimit të nevojave në kontekstin e rehabilitimit, integrimin në tregun e punës dhe të shërbimeve shoqërore... Paketa mbështetëse me subvencione shtesë/bonuse për vaksinimin dhe arsimimin e fëmijëve, si dhe ofrimi i paketës së ndihmës në natyrë tregon vëmendjen e shtuar për të asistuar familjen në tërësi duke integruar të gjitha llojet e shërbimeve publike...*”<sup>12</sup>.

Në rastin konkret, gjatë hetimit administrativ të kësaj çështje dhe provave të vëna në dispozicion nga palët, rezultoi se, pavarësisht ekzistencës së legjislacionit të aplikueshëm dhe faktit që nxënësit i sigurohet e drejta për arsimim cilësor dhe mundësi të barabarta, nxënësit e familjeve në nevojë dhe atyre me vështirësi u ofrohet kujdes i veçantë nga shteti, duke përfutur lehtësira në ushqim, mensa, bursa financiare, rezultoi që nxënësja V.Ç fëmijë i subjektit ankues, nuk ka përfutur këtë bursë, e cila i njihet sipas akteve në fuqi.

Megjithatë, duke mbajtur në konsideratë detyrimin dhe përgjegjësitë e shtetit për të vënë në dispozicion fonde publike për të garantuar aksesin në arsim, sipas meritës, pavarësisht nga mundësitë financiare të individëve, Komisioneri thekson se, vendosja e një sistemi të përshtatshëm bursash, përbën një nga mjetet për të siguruar realizimin e plotë dhe në baza të barabarta për të gjithë të të drejtës për arsim.

Nga ana e Bashkisë Korçë, për nxënësit që plotësonin kriteret për vitin shkollor 2025–2026, por që nuk rezultuan përfutues të bursës, Bashkia, në cilësinë e pushtetit vendor dhe të politikave të saj

<sup>11</sup> Miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave Nr. 621, datë 22.10.2021.

<sup>12</sup> Objektivat e Strategjisë Kombëtare të Mbrojtjes Sociale 2024-2030.

sociale, ka pasur mundësinë dhe detyrimin të mbulonte këto familje përmes skemave financiare nga fondet e veta. Pushteti vendor disponon të gjitha instrumentet ligjore dhe administrative për të përmbushur detyrimet ndaj familjeve në nevojë, duke siguruar që nxënësit që përballen me vështirësi ekonomike të mos mbeten pa mbështetje, përfshirë: fonde për arsimin parauniversitar, skema sociale për mbështetje të familjeve në nevojë, dhe mbështetje direkte për nxënësit që nuk e kanë përfituar atë për shkak se Ministria përgjegjëse për arsimin nuk i ka akorduar të plota këto fonde sipas nevojës. Mosveprimi i Bashkisë në këtë rast tregon një dështim të qartë në zbatimin e detyrimeve të pushtetit vendor për sigurimin e barazisë dhe mbështetjes sociale për nxënësit në situata të vështira ekonomike.

Bashkia Korçë, për vitin shkollor 2025–2026, është shprehur se edhe për këtë vit numri i aplikantëve që plotësonin kriteret ligjore për përfitimin e bursës ishte më i lartë se numri i kuotave të vëna në dispozicion nga Ministria e Arsimit, ndërkohë që nga ana e saj ka akorduar vetëm 40 kuota shtesë. Në këtë kontekst, vlerësohet e rëndësishme të theksohet se: së pari, numri i aplikimeve për përfitimin e bursave ka ardhur në rritje nga viti në vit, duke reflektuar një nevojë gjithnjë e më të lartë për mbështetje sociale në këtë kategori; së dyti, ky qëndrim rezulton të jetë i përsëritur, pasi çështje të ngjashme janë trajtuar ndër vite nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, i cili ka dhënë rekomandime për adresimin e kësaj problematike.

Bazuar në tërësinë e fakteve dhe provave të administruara në lidhje me rastin konkret, Komisioneri vlerëson se Bashkia Korçë dhe Ministria e Arsimit nuk arritën të provojnë dhe të jepnin një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm, lidhur me trajtimin e padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë të cilit i është nënshtruar nxënësja Veljona Ç.

Sa më sipër, rezulton plotësisht e provuar lidhja shkakësore midis shkaqeve të mbrojtura aftësia e kufizuar dhe gjendja ekonomike dhe trajtimit të pafavorshëm dhe të pabarabartë, të cilit i është nënshtruar nxënësja Veljona Ç.

Komisioneri arrin në përfundimin se, mospërfitimi i bursës për vitin shkollor 2025-2026, nga ana e nxënëses V.Ç, si pasojë e veprimeve dhe mosveprimeve të Bashkisë Korçë dhe Ministrisë së Arsimit, e ka ekspozuar atë ndaj një trajtimi të padrejtë, të pafavorshëm dhe të pabarabartë, duke i mohuar të drejtën për të përfituar këtë bursë sipas kriterit 2.3/d dhe 2.1/c, të VKM nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.

Neni 3/2 i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ka përcaktuar se konsiderohet si *“Diskriminim i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person ose grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, ose një grup tjetër personash në një situatë të njëjtë a të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.*

Neni 3/4 i ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, ka përcaktuar se konsiderohet si “*Diskriminim për shkak të shoqërimit*” ajo formë diskriminimi që ndodh kur ka një dallim, kufizim ose preferencë për arsye të shoqërimit me persona që u përkasin grupeve të përmendura në nenin 1 të këtij ligji, si dhe për shkak të supozimit për një shoqërim të tillë.”

Komisioneri konstaton se, fëmija e palës ankuese është diskriminuar nga ana e Bashkisë Korçë dhe Ministrisë së Arsimit, pikërisht për shkakun e pretenduar, atë të aftësisë së kufizuar të nënës. Komisioneri konstaton se fëmija i ankueses, si anëtare e familjes që njërin nga prindërit/nënë e ka me aftësi të kufizuara dhe anëtare e një familje në nevojë që trajtohet me ndihmë ekonomike, është vënë në pozita jo të favorshme, duke u mohuar mundësia për të përfituar bursë, me qëllim sigurimin e arsimit gjithëpërfshirës për të, si pjesë e kategorisë së nxënësve përfitues. Pra, fëmija e ankueses është vënë në pozita përjashtuese dhe diskriminuese, nga ana e Bashkisë Korçë dhe Ministrisë së Arsimit, për shkak të aftësisë së kufizuar të nënës së saj dhe gjendjes ekonomike.

Bazuar në nenin 33, pika 10 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, përcaktohet se: “*Vendimi përmban rregullimet dhe masat e duhura, duke caktuar edhe një afat për kryerjen e tyre*”, ndërsa në nenin 33, pika 12, përcaktohet se : “*Kur vendos masën, komisioneri siguron që ajo të jetë: a) e efektshme dhe parandaluese; dhe b) në përpjesëtim me gjendjen që e shkaktoi vendosjen e masës*”.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, i ndryshuar, në nenin 33/10, nuk ka përcaktuar masat që duhen marrë për rregullimin e situatës diskriminuese, por e ka lënë në diskrecionin e Komisionerit. Pra, Komisioneri rast pas rasti, vendos se cilat janë rregullimet dhe masat që duhen marrë në mënyrë që të sigurojë mbrojtjen efektive nga diskriminimi të personave që pretendojnë se janë viktima të diskriminimit. Ky ligj, nëpërmjet nenit 33/12, ka vendosur kriteret që duhet të ndjekë Komisioneri në përcaktimin e masës që ai jep nëpërmjet vendimeve të tij.

Bazuar në sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, masa e duhur për rregullimin e situatës diskriminuese është marrja e masave nga ana e institucioneve përgjegjëse, që të sigurojnë dhënien e tarifës së bursës së mohuar për vitin shkollor 2025-2026.

Komisioneri vlerëson se Bashkia Korçë dhe Ministria e Arsimit duhet të kenë në konsideratë këto kategori nxënësish, të cilët, për shkak të gjendjes së vështirë ekonomike dhe sociale dhe faktit që fëmija është përfitues për shkak të të qenit fëmijë i një prindi me aftësi të kufizuara dhe njëkohësisht si fëmijë i një familje në nevojë që trajtohet me ndihmë ekonomike, ndodhen në kushte vulnerabël, me qëllim garantimin, njësoj si për të gjithë nxënësit e tjerë, të së drejtës për arsimim dhe barazi në përfitimin e mbështetjes financiare.

Gjithashtu, Komisioneri vlerëson se Ministria e Arsimit duhet të marrë masa konkrete për të bashkëpunuar, koordinuar dhe konsultuar me njësitë e vetëqeverisjes vendore gjatë procesit të përcaktimit të kuotave, duke i përshtatur ato në mënyrë proporcionale me nevojat reale të bashkive.

Ky proces është i domosdoshëm për të mundësuar vlerësimin dhe adresimin efektiv të problematikave të evidentuara, me qëllim shmangien e situatave të tilla në të ardhmen dhe garantimin e barazisë në aksesin ndaj përfitimeve, duke parandaluar sjellje me efekt diskriminues.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Mbështetur në nenin 1, nenin 7/1, nenin 11, nenin 32, pika 1, germa a) e nenin 33, pikat 10-11, të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, të ndryshuar, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I:**

1. Konstatimin e *diskriminimit në formën e shoqërimit*<sup>13</sup> për shkak të *aftësisë së kufizuar* të nënës së saj dhe *diskriminimit të drejtpërdrejtë*, për shkak të *gjendjes ekonomike*, të nxënëses V.Ç<sup>14</sup>, nga ana e Bashkisë Korçë dhe Ministrisë së Arsimit.
2. Bashkia Korçë dhe Ministria e Arsimit, të marrin masa, për sigurimin e fondeve të nevojshme dhe dhënien e tarifës së bursës për vitin 2025-2026 sipas VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar, për nxënësen V.Ç.
3. Ministria e Arsimit dhe Bashkia Korçë, të marrin masa konkrete për sigurimin e numrit të kuotave të nevojshme për dhënien e bursave, për të gjitha kategoritë përfituese, sipas VKM-në nr. 666, datë 10.10.2019 “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte dhe përcaktimin e kriterëve për përfitimin e bursave e të pagesave për nxënësit e arsimit parauniversitar në institucionet arsimore publike”, të ndryshuar.
4. Për të shmangur situatën e krijuar në rastin konkret, rekomandohet Bashkia Korçë dhe Ministria e Arsimit, të marrin masa, për një bashkëpunim më intensiv dhe të frytshëm, për koordinimin dhe konsultimin mes pushtetit vendor dhe atij qendror, gjatë procesit të hartimit kuotave në proporcion me nevojat e bashkisë.
5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijani për këtë vendim, Bashkia Korçë dhe Ministria e Arsimit, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat konkrete të marra për zbatimin e këtij vendimi.

<sup>13</sup> Si fëmijë të një personi me aftësi të kufizuar.

<sup>14</sup> Përfaqësuar në këtë ankesë nga nëna M.Ç.

6. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010, “*Për Mbrojtjen nga Diskriminimi*”, i ndryshuar, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë, sipas parashikimeve të pikës 13, të po këtij neni.
7. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani.

**KOMISIONER**

**Genta Tafa (BUNGO)**

Shkaku: Aftësi e kufizuar, gjendje ekonomike  
Fusha: Arsim  
Lloji i vendimit: Diskriminim në formën e shoqërimit/Diskriminim i drejtpërdrejtë